



V E N D I M

Nr. 37 Datë 21.03.2008
PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E RREGULLORES TË
PROCEDURAVE TË LICENSIMIT

Në mbështetje të nenit 9, të Ligjit nr. 9072, dt 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar; neneve 18, pika 1, germa g, dhe 26, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.44 datë 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datë 21.03.2008, pasi u njoh me propozimin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi nevojën për një shtesë në rregullat e procedurave të licensimit lidhur me afatet e licensimit për veprimtaritë e eksportit dhe importit të energjisë elektrike,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e Rregullores për procedurat e licensimit.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, për hartimin e ndryshimeve në rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s

Bujar Nepravishta